



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 5762 Prot.

Maliq, më 20.11.2020

**NJOFTIM**

**LËNDA:** Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Maliq

**DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ**

**KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ**

**Të nderuar,**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, "Funksionimi i këshillit bashkiak", pika 2, pika 4, neni 56 "Kryetari i këshillit bashkiak" gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq" ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq, do të zhvillohet elektronikisht, si pasojë e zbatimit të protokolleve të sigurisë mbi COVID-19, ditën e **premtë më datë 27.11.2020, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve pranë këshillit bashkiak "Mbi heqjen e mandatit të këshilltarit për znj. Aleksandra Bardhi Kinolli, pas ndryshimit të vendbanimit jashtë territorit të bashkisë ku është zgjedhur";
3. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin tetor 2020";
4. P-V "Për miratimin e fillimit të procedurës për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara nr.373 dhe 374/6, ZK 1900, Gurishtë, NJA Pirg, Bashkia Maliq";
5. P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e këshillit të bashkisë nr.71, datë 30.09.2019 "Për miratimin e listave të tokave të pandara me qëllim dhënien me qira të tyre, për NJA Pirg, Vreshtas dhe Pojan të Bashkisë Maliq" i ndryshuar";
6. P-V "Për dhënien me qira të një sipërfaqeje pranë ish-Kombiantit të Sheqerit sh.a Maliq";
7. Diskutime të tjera.

*Ju faleminderit!*

**KRYETARI I KËSHILLIT**  
**Ornildi DEMOLLARI**

